



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 1041/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevcu anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ) në Prishtinë, për mbajtjen e tubimit publik, për raundin e dytë të zgjedhjeve për Kryetar të Komunave, në seancën e panelit të mbajtur më datë 13.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

KONSTATOHET e tërhequr ankesa e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, me shenjën ZL.Anr.1041/2017 e datës 11.11.2017, paraqitur kundër Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ) në Prishtinë, për mbajtjen e tubimit publik, për raundin e dytë të zgjedhjeve për Kryetar të Komunave.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë ZL.Anr.1041/2017 me datën 11.11.2017, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, me të cilën ka theksuar se përmes Ftesa pwr mbajtjen e Tubimit Publik (FNJMTP), ka bërë kërkesë ZLKZ-së, për mbajtjen e tubimit përmbyllës të fushatës parazgjedhore për raundin e dytë të zgjedhjeve për Kryetar të Komunave, në Sallën “1 Tetori” në Prishtinë, të planifikuar për datën 17.11.2017. Ndërsa, ZLKZ ka vendosur që të mos miratohet kërkesa e subjektit politik LVV për mbajtjen e tubimit publik.

Mirëpo, subjekti politik LVV, me anë të parashtrësës të dorëzuar në PZAP më datë 13.11.2017, e ka njoftuar PZAP-in se, Komisioni Komunal Zgjedhor (KKZ) në Prishtinë me datë 12.11.2017, ka miratuar kërkesën e LVV në lidhje me rezervimin dhe mbajtjen e tubimit publik përmbyllës me datë 17.11.2017, në Sallën 1 Tetori, prandaj LVV, nuk e sheh të arsyeshme vazhdimin e kësaj çështje pasi që kërkesa për mbajtjen e tubimit publik i është miratuar.

Andaj PZAP në mbështetje të nenit 115 par. 1 të LZP, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr.1041/2017 më datë 13.11.2017

Kryesuese e Panelit
Rafet Hashaj

Udhëzim Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.

